

KONTRATË SHITJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË

Sot, më datë 14/01/2020, palët e mëposhtme:

Znj. Erida Belulaj, shtetase shqiptare, lindur më 26.05.1985, me numrin personal I55526081C, me zotësi të plotë për të vepruar (që më poshtë do të quhet "**Shitësi**").

DHE

Z. Bledar Manaj, shtetas shqiptar, lindur më 01.10.1975, me numrin personal H51001786E, me zotësi të plotë për të vepruar (që më poshtë do të quhet "**Blerësi**").

Shitësi dhe Blerësi do të referohen bashkerisht si "**Palët**".

Palët bien dakort të nënshkruajnë këtë kontratë shitje të kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE

Kapitali i shoqërisë **MB Consulting SHPK**, me NUIS L21428011V, me seli në Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Abdyl Frasheri, Ndertesa 8, Hyrja 7, Ap.25, 1019, Tiranë, Shqipëri (këtu e më poshtë referuar si "**Shoqëria**") është i përbërë nga 2 (dy) kuota.

Shitësi **Znj. Erida Belulaj** zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 51,000 (pesëdhjetë e një mijë) LEKE, që përkon me 51% të kapitalit themeltar.

Blerësi **Z. Bledar Manaj** zotëron 1 (një) kuotë me vlerë nominale 49,000 (dyzet e nëntë mijë) LEKE, që përkon me 49% të kapitalit themeltar.

Neni 1 Objekti i Kontratës

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes, 1 (një) kuotë me vlerë nominale 51,000 (pesëdhjetë e një mijë) LEKE, që përkon me 51% të kapitalit themeltar.
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë kuotën e kapitalit të Shoqërisë.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil Shqiptar dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 2 Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Transferimi i kuotës së kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi do të kryhet përkundrejt pagesës prej:
- 51,000 (pesëdhjetë e një mijë) LEKE ndaj Shitësit **Znj. Erida Belulaj**.
- 2.2 Palët deklarojnë së çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 3
Kalimi i Pronësisë

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet zotërues i kuotës korresponduese me 100 % të kapitalit të Shoqërisë, titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me të, dhe pëfitues i fitimeve të Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

Neni 4
Garancitë

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kuota e kapitalit të shoqërisë objekt i kësaj kontrate, është e transferueshme dhe e lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5
Forca Madhore

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardolloj dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qëndror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 6
Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

Neni 7
Legjislacioni i zbatueshëm

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

Neni 9
Shpenzimet

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të jenë në ngarkim të Blerësit.

Neni 10
Ndryshimet

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

**Neni 11
Hyrja ne fuqi**


11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

**Neni 12
Gjuha e kontratës**


12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.

Palët

SHITËSI


ERIDA BELULAJ

BLERËSI


BLEDAR MANAJ

